



REPUBLIKA E SHQIPERISË
SHKOLLA 12-VJEÇARE JOPUBLIKE „HAFIZ IBRAHIM DALLIU“

Adresa: Rruga „Dritan Hoxha“, ndërtesa nr. 1, Laprakë, Tiranë.
E-mail: ibrahim.dalliu@gmail.com/Web: www.ibrahimdalliu.edu.al

Tel: [+355 \(0\) 422 70 230](tel:+355042270230)/ Cel: [+355 \(0\) 67 30 10 200](tel:+3550673010200)

Tiranë, më 01.05.2020

URDHËR

Nr. 11.

“Për organizimin e mësimit, vlerësimin e nxënësve dhe mbylljen e vitit shkollor për klasat XII .”

Drejtuar: Mësuesve të IAJP-„H. Ibrahim Dalliu” që japin mësim në klasat XII A dhe B.

Mbështetur në Rr.B.Sh. neni 105, pika 1), në zbatim të urdherit nr. 45, dt. 29.04.2020 për “Për organizimin e mësimit, vlerësimin e nxënësve dhe mbylljen e vitit shkollor 2019-2020 për klasën XII urdhëroj:

1. Viti shkollor për klasat XII do të përfundojë në datën 05.06.2020 sipas strukturës së fillimvitit shkollor2019-2020,
2. Provimet e Maturës Shtetërore do të zhvillohen në datat 08-18.06.2020,
3. Mënyra e të vepruarit për vijueshmërinë e dhe realizimin e programit do të jetë si më poshtë (Faza I 04.05.-15.05.2020):
 - a) Nxënësit e klasave XII do të vijojnë mësimin në online deri në **dt. 15. Maj 2020**
 - b) Mësuesit e lëndëve: Ekonomi XII-B, Edukim fizik XII-A/B, Arabisht XII-A/B, Fizikë XII-A, Biologji XII-A, TIK XII-A/B, Psikologji XII-A/B të llogarisin mbylljen e programit mësimor deri në datën 30 prill 2020.
 - c) Mësimi online për klasat XII do të vazhdojë vetëm për lëndët: Gjuhë shqipe dhe letërsi XII-A/B, Anglisht XII-A/B, MatematikëXII-A/B, Ekonomi XII-A, Fizikë XII-B, Biologji XII-B, nga dt. 04.05. deri në dt.15.05.2020 sipas orarit mësimor aktual që kanë,
 - d) Klasat e pikës c) do të **zhvillojnë VETËM PËRSËRITJE** duke u bazuar në programet e rishikuara të ASCAP (ato që janë dërguar sëfundmi),
 - e) Mësuesit të zbatojnë me rigorozitet orarin mësimor dhe të vazhdojnë të mbajnë shënime për pjesëmarrjen e nxënësve në mësim (mungesat) dhe temën mësimore të zhvilluar.
 - f) Temat e përsëritjes nga dt. 04.05. deri në datën 15.05. të shtohen në planifikimin e periudhës së tretë.
 - 3.1. Faza II, rikthimi në shkollë 18.05. deri 05.06.2020)
 - a) Nxënësit do të kthehen në shkollë në dt. 18.05.2020 dhe do të vazhdojnë mësimin deri në datën 05.06.2020,
 - b) Gjatë kësaj periudhe ata do të zhvillojnë sipas orarit përkatës vetëm lëndët e përcaktuara në pikën 3/c).(Pra vetëm lëndët që kanë provim të maturës),

- c) Temat e zhvilluara gjatë kësaj periudhe do të vazhdojnë të jenë **VETËM PËRSËRITJE** duke u bazuar në programet e rishikuara të ASCAP (ato që janë dërguar sëfundmi) dhe do të përfshihen në planifikimin e periudhës së tretë,
 - d) Gjatë kthimit në shkollë mësuesit që do të japin mësim në lëndët përkatëse do të shënojnë temat në regjistër sipas planifikimeve të rregulluara, ketu P3,
 - e) Në kohën e kthimit në punë mësuesit e të gjitha lëndëve do të hedhin në regjistër temat përkatëse sipas planifikimeve dhe përcaktimeve në këtë urdhër (temat e realizuara) duke shënuar numrin e orëve të realizuara dhe numrin e orëve të porealizuara gjatë këtij viti shkollor,
 - f) Mësuesit kujdestar në bazë të plotësimit të tabelave përmbledhëse të P1 dhe P2 do të hedhin në regjistër mungesat e nxënësve sipas kërkesave të regjistrit. (Edhe mungesat e P.3). Mungesat do të hidhen në regjistër për çdo nxënës dhe lëndë individualisht nga mësuesi i lëndës, mësuesi kujdestar rakordon dhe plotëson detyrimet e tija (përmbledhjet mujore, të periudhave dhe ato vjetore).
4. Organizimi i mësimin gjatë kthimit në shkollë do të bëhet si më poshtë:
- a) Klasat do të vendosen në katin 3 klasa B dhe 4 klasa A sipas parimit të ruajtjes së distancës dhe rregullat përkatëse të mbrojtjes (dorashka, mask) dhe dezinfektues me vete. Kjo vlen për nxënësit dhe mësuesit njëkohësisht)
 - b) Orari i fillimit dhe mbarimit të mësimin do të përcaktohet në vijim dhe hartohet nga nëdrejtori,
 - c) Sipas mundësisë shkolla do të mundohet të sigurojë transport për nxënësit që janë larg në bazë të një tarife të arsyeshme, gjithmonë nëse mbledhja e nxënësve është e mundur në këtë lloj forme,
 - d) Klasa A sipas situatës dhe ambientit do të ndahet në dy klasa nëse do të jetë e nevojshme,
 - e) Për lëndët me zgjedhje nxënësve që kanë lëndën si provim me zgjedhje do të zhvillojnë mësimin në klasa të ndara sipas lëndëve me zgjedhje (Biologji A/B, Ekonomi, A, Fizikë B),
 - f) Sa i përket orarit mësimor nxënësit do të zhvillojnë çdo ditë vetëm lëndët e provimeve të MASH (gjuhë shqipe dhe letërsi, anglisht, matematikë dhe lëndë me zgjedhje)
 - g) Gjatë muajit qershor të gjithë mësuesit që japin mësim në klasat e maturës do të plotësojnë tabelat e përfundimeve vjetore (rezultatet, mungesat etj, regjistrat dhe çdo detyrim tjetër ndaj drejtorisë dhe institucionit,
5. Procedura e vlerësimit për maturat, nxjerrja e përfundimeve dhe plotësimi i dokumentacionit.
- a) Gjatë gjithë periudhës së mësimin (online dhe fizike), mësuesit do të vazhdojnë të mbajnë shënime në evidencën e VV (personalen) për: vlerësimin e detyrave që kryen nxënësi, gadishmerinë, interesin dhe angazhimin që tregon ai për të komunikuar me mësuesit dhe pjesëmarrjen në procesin mësimor (online dhe fizik). (Mësuesit të bazohen gjatë kësaj periudhe vetëm në këto aspekte/kritere dhe të formatojnë evidencën e VV sipas këtyre pikave (nëse është e nevojshme)),
 - b) Përfundimet e periudhës së dytë do të qëndrojnë sipas vlerësimeve të bëra,

- c) Sa i përket periudhës së tretë (prill – maj) **nxënësit nuk do të vlerësohen me notë në regjistër për asnjë nga llojet e vlerësimit,**
- d) **Në bazë të angazhimit dhe pjesëmarrjes që nxënësi ka treguar gjatë mësimit online dhe do të tregojë gjatë mësimit fizik mësuesi do të vendosë nëse nxënësit do t'i ngrejë vetëm një notë në vlerësimin përfundimtar apo jo,**
- e) Përfundimet do të dalin vetëm me vlerësimet e bëra gjatë periudhës së parë dhe periudhës së dytë, ku mësuesi duhet të marrë më në konsideratë vlerësimet gjatë frekuentimit të nxënësit dhe të nxjerrë përfundimet përkatëse sipas parimit të progresivitetit/regresivitetit dhe pikës 4- c) dhe d) të këtij urdhëri,
- f) Sa i përket periudhës së tretë në regjistër mësuesi **të kolonat e përfundimeve/vlerësimeve të periudhës do të shënojë për të treja llojet e vlerësimeve NK (Nuk u Krye).** Kjo notë **NUK do të llogaritet në nxjerrjen e vlerësimit vjetor të nxënësit për asnjë nga llojet e vlerësimeve.**
- g) Sa i përket vlerësimit përfundimtar veç parashikimeve të pikës 5-e) të këtij urdhëri, për shkollën „H.I.Dalliu“ do të zbatohet „skanari 1“ i përmendur në urdhërin 45, pika 8-e) i cili sipas urdhërit do të sqarohet me udhëzimin përkatës për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimit në kushte shtëpie për vitin shkollor 2019-2020 (!).
- h) Për të nxjerrë vlerësimin përfundimtar për klasën XII, mësuesi do të marrë në konsideratë arritjet e nxënësve që nga fillimi i vitit shkollor dhe do të përqendrohet kryesisht në rezultatet e aritura gjatë kohës së mësimit të zhvilluar para mbylljes së institucioneve arsimore (për HID dt. 10.03.2020). Nëse nxënësi ka vijueshmëri të rregullt dhe angazhim të mirë e cilësor gjatë periudhës së mësimit në kushte shtëpie mësuesi do marrë parasysh këtë fakt dhe në vlerësimin përfundimtar do të ketë ndikim pozitiv duke i shtuar **një notë** .
- i) Nëse vlerësimet e nxënësit në periudhën e dytë janë regresive, mësuesi do përqendrohet te pjesëmarrja dhe **angazhimi cilësor** i nxënësit sipas mundësive duke vepruar sipas pikës i) të mësipërme për nxjerrjen e përfundimeve.
- j) Sa i përket rubrikës së vlerësimit të kompetencave në regjistër, mësuesi shton gjatë përshkrimit edhe argumente të pjesëmarrjes dhe angazhimit cilësor në mësimin online dhe atë fizik (18.05-05.06) të nxënësit.

Ngarkohen me zbatimin e këtij urdhëri nëndrejtori i shkollës, sekretarja e shkollës dhe mësuesit që japin mësim në klasat XII.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë!

DREJTORI SHKOLLËS

Klodian ZAIMI



